



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.395/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtararë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Obiliq, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të palejuara ankesat ZL.A.nr.395/2017, ZL.A.nr.397/2017, e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal të Obiliqit, Shkurte Raçi nga radhët e subjektit politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, të paraqitura me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa nga Shkurte Raçi, kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal të Obiliqit, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilat pretendon se i janë keqpërdorur votat, në Qendrat e Votimit të Komunës së Obiliqit, si në: Vendvotim nr.1501e/05/R, në shkollën fillore “Ibrahim Rugova” në Obiliq; Vendvotimi 1520e/02D në Mazgit të Epërm.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.395/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlihen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hudh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se

ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.395/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*